



Prishtinë, 10 prill 2015
Kodi i ZRRE-së: V_729_2015

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 14, paragrafi 2.17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, dhe
- Kërkesën e KQKO për aprovimin e dokumentit Procedura e Menaxhimit të Kodeve Teknike/Operacionale (KQKO) të datës 27 mars 2015,

në seancën e mbajtur me datë 10 prill 2015, nxori këtë:

VENDIM

I. APROVOHET dokumenti Procedura e Menaxhimit të Kodeve Teknike/Operacionale (KQKO)

Arsyetim

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 17.03.2015 ka pranuar kërkesën e KQKO për shqyrtimin dhe komentimin e dokumentit Procedura e Menaxhimit të Kodeve Teknike/Operacionale të harmonizuar me Ligjet në fuqi, i cili e shfuqizon procedurën e aprovuar më 31.01.2007, me vendimin D_31_2007.
 - o Gjatë zhvillimit të dokumentit, ZRRE ka dhënë komente si pjesëmarrëse aktive në grupin e KQKO-së.
 - o Pas këtyre zhvillimeve, KQKO me datë 27.03.2015 ka bërë kërkesë zyrtare në ZRRE për aprovimin e dokumentit Procedura e Menaxhimit të Kodeve Teknike/Operacionale.
 - o Pas vlerësimit të kërkesës, ZRRE ka parë të arsyeshme që të lejojë aprovimin e dokumentit Procedura e Menaxhimit të Kodeve Teknike/Operacionale.
- II.** Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- III.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, ku do të publikohet edhe dokumenti. Dokumenti do të publikohet edhe në faqen elektronike zyrtare të KOSTT-it.



Këshillë juridike: Palët e pakënaqura me këtë Vendim mund të iniciojnë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimt të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Vendimit i bashkëngjitet dokumenti Procedura e Menaxhimit të Kodeve Teknike/Operacionale.

Bordi i ZRRE-së


Enver Halimi, kryesues


Merita Kostari, anëtare


Krenar Bujupi, anëtar